

# ALL NATIONS GOSPEL PUBLISHERS



[www.anjp-hb.co.za](http://www.anjp-hb.co.za)



[info@anjp.co.za](mailto:info@anjp.co.za)

# **ZEMRA E NJERIUT**

Copyright ANGP

## **COPYRIGHT**

**ISBN 1 - 874934 - 03 - 7**

**E-MAIL: [info@angp.co.za](mailto:info@angp.co.za)**

**ALL NATIONS GOSPEL PUBLISHERS**

**P.O. Box 2191, PRETORIA, 0001, R.S.A.**

(A Gospel Literature Mission financed by donations)  
(Reg. No. 1961/001798/08)

## Zemra e njeriut

### Vepra e Zotit ose aktiviteti i satanait

Duke lexuar këtë librezë të lutem që gjithmonë të kesh në mendje që kjo është një pasqyrë në të cilën do të mundesh të shikosh vetvenet. Pa marrë parasysh se je pagan ose i krishterë, besimtar apo renegat, do të shikosh ashtu sikur dhe ty të shikon Zoti çfarë i kap syri, ndërsa Zoti shikon brenda në zemër.

Perëndia nuk bën dallim njerëzish.

Satanai (djall), është babai i të gjitha rrenave.

Ai është princi i territ dhe zoti i kësaj bote, i cili maskohet si engjëll i drithës, që të mund të mashtrojë njerëzit. Në kohën e sotme dhe në të kaluarën, ka pasur dhe ka shumë apostuj të rremë të cilët hiqen si apostuj të Krishtit. Nuk është çudi që dhe vetë Satanai, zoti i kësaj bote të shthurur, duke u hequr si engjëll, verbon sytë dhe mendjen e njerëzve, kështu që njerëzit nuk shikojnë që zoti i puth, dhe se Krishti ka vdekur për shpëtimin e tyre. Pra, satanai, që gjithmonë gënjen, edhe në këtë rast na gënjen me paraqitjen e tij si engjëll (2. Kor. 11.13-14). Por ata që nuk besojnë dhe bëjnë faje, janë të vdekur për Zotin. Tek ata sundon fryma e zotit të kësaj bote (Efes. 1.2). Në se nuk iu hapen sytë e nuk shikojnë gjendjen tyre të humbur-shkojnë në shkatërrim të përhershëm. Ai që thotë: «Unë jam pa mëkat», mashton vetvenet (1. Gjoni 1,8). «Për këtë është dashur të vijë biri i Zotit që të shkatërrojë veprat e djallit» (1. Gjoni 3,8).

«Nënshtrojuni pra Zotit e kundërshtoni djallin dhe ai, do të ikë nga ju» (Jak. 4,7-8). Duke lexuar këtë librezë e duke i studiuar fotografitë e saj, do të mund të shikosh zemrën tënde. Lejo, o njeri, që të dërguarit e Zotit, që janë jashtë zemrës sate e presin, të shpjegojnë gjendjen e zemrës sate.

Prano ti mëkatet e fajet e tua dhe mos e moho qenien e tyre, sepse Fjala e Zotit na thotë: «Në se themi se nuk kemi faje, veten tonë mashtrojmë dhe e vërteta nuk është tek ne. Nëse i pranojmë

fajet tona, atëherë Zoti që është besnik dhe i drejtë na i fal fajet tona dhe na pastron nga çdo padrejtësi» (Gjoni 1.8-9). Në qoftë se je nën pushtetin e djallit ose të Zotit dhe vazhdon të veprosh nga të dyja anët, je fajtor. Pra, duhet të zgjedhësh, o njerën-o tjetrën. Në qoftë se jeta jote është e dhënë pas dëshirave rimore, mos e vërteto se kështu është, por kthehu nga Zoti. Ai ka për të të liruar me anë të Jezu Krishtit, i cili ka ardhur në këtë jetë që të shpëtojë fajtorët dhe të thyejë pushtetin e djallit e fajet tona. Ai është shpëtimtari dhe çliruesi ynë. Je afér Zotit të Shenjtë, i cili shikon gjithë fshehtësirat dhe mendimet e fshehta, i cili shikon veprat e jetës sate. Është e pamundur të mbulosh veprat e tua para Zotit, sepse Ai, «i cili ka formuar veshin, a nuk dëgjon? Dhe i cili ka krijuar syrin, a nuk shikon?» (Psalmi 94.9).

«Sepse sytë e Zotit, shikojnë nëpër Tokën e tij, që të tregojë fuqinë e vet para atyre që e kanë zemrën të hapur para Atij» (2. Ditari 16.9).

«Sepse sytë e tij janë të drejtuar në rrugët e njeriut dhe shikojnë hapat e tij. Nuk ka errësirë as hije të vdekjes ku mund të mbulohen ata të cilët bëjnë padrejtësi» (Job. 34.21-22).

«Por dhe vetë Krishti nuk i ka besuar se i ka njojur të gjithë» (Gjoni 2.24).

«Lum ai, të cilët i është falur mëkati (faji)». «Lum njeriu, të cilin Zoti nuk e fajëson dhe në shpirtin e të cilët nuk ka fare mashtrim (Psalmi 32.1-2) (Lexo edhe psalmin 51). Jezusi na thërrret dhe sot: «Ejani këtu tek unë, të gjithë ju që jeni të munduar dhe të ngarkuar dhe unë do t'ju shlodh» (Mateu. 11.28-30).

## Tregim në dhjetë fotografi

### Fotografia e parë

Kjo fotografi na tregon zemrën e një njeriu (ose gruaje) të papërtërirë, mondan, që Bibla e përcakton mëkatar, i cili

udhëhiqet nga fryma e kësaj bote, nga dëshirat dhe pasionet e trupit.


Kjo është pamja reale e asaj zemre, ashtu siç e shikon Zoti. Sytë e skuqur tregojnë se është i dehur ashtu si thuhet në Prov. 23.299-33. «Për kë janë ‘ah’ – et, për kë janë ‘obobo’ – të? Për kë grindjet? Për kë ankimet? Për kë plagosjet pa arsy? Për kë sytë e skuqur? Për atë që rri gjatë afër verës, për ata që shkojnë të shijojnë verën e droguar. Mos e shiko verën kur kuqëlon, kur shkëlqen në gotë dhe kalon shpejt poshtë! Në fund ajo të kafshon si gjarpëri dhe të shpon si përbindëshi. Sytë e tu do të shkojnë gjëra të çuditshme e zemra jote ka për të folur pa mend» (Prov. 23.29-33).

Në këtë fotografi poshtë kokës së njeriut shihet zemra në të cilën banojnë shumë kafshë të llojeve të ndryshme, të cilat paraqesin mëkatet e ndryshme, sepse zemra është vendi i mëkateve tonë. Zoti nëpërmjet gojës së profetit Jeremi na thotë: «Zemra është mashtruese dhe shumë e mbrapshtë, kush dëshiron ta njohë?» (Jer. 17.9). Dhe Jezusi e konstaton këtë dhe thotë: «Sepse prej mbretërisë së zemrës së njeriut dalin mendimet e këqija si ndyrësia; kurvëria; vrasja; vjedhja; lëkmia, ligësia; pija; mëndjemadhësia; marrëzia; etj. Gjithë këto të këqija dalin nga brenda dhe e ndyjnë njeriun...» (Marku 7.21-23).

## 1. Palloj

Çdo njeriu i pëlqen bukuria e palloit, por këtu, në zemrën e njeriut ai paraqet mëkatin e mburrjes. Luciferi, mbrojtësi Kerubin, ndriçuesi i dikurshëm i Zotit, lajmëtar i Zotit, ka rënë në këto të meta, e kështu është bërë armiku i Zotit-djall (Isai 14.9-17), (Ezehijel 28.12-17).

Mburrja ka ardhur nga thellësia e Ferrit (skëterrës), dhe shfaqet në mënyra të ndryshme. Disa njerëz krenohen me pasurinë e tyre, diturinë, veshjen sipas modës, me anë të së cilës paraqesin trupat e tyre në mënyrë të turpshme, me zbukurime, varëse,



1. Zemra e mëkatarit.

unaza të çmueshme etj. siç është shkruar tek Isai (3.17-24). Disa mburren me stërgjyshërit e tyre, me kombësinë e tyre, me kulturën e tyre, me sportin, duke haruar se «Zoti kryelartëve u kundërvihet dhe të përulurve u jep bekim» (Pjetri 5.5). Zoti e kundërshton mburjen dhe madhështinë (Prov. 8-13). (Mëndjemadhesia vjen para humbes, ndërsa mburrja përparrë shkatërrimit) (Prov. 16.18).

## 2. Cjapi

Paraqet epshet trupore, imoralitetin, kurvërinë. Këto janë shtuar aq shumë sidomos në ditët e sotme sa që duhet të pranojmë të vërtetën e fjalëve të Krishtit i cili afërsisht para 2000 vjetëve ka thënë që ditët e fundit do të janë si ditët e Sodomës e të Gomorrës<sup>1</sup>. «Fryma moderne» ka përfshirë jo vetëm meshkuj e femra, por ka hyrë dhe në shtëpitë e njerëzve fetarë, në institucione, në shkolla e në kolegje studentore; gjithashtu kjo farë korrupzioni është hedhur pacipërisht e djallëzisht në zemrat e njerëzve me anë të kinematografisë, teatrit, televizionit, botimeve pornografike dhe me shumë mënyra të tjera, kështu që atë që Zoti e quan mëkat-sot e quajnë «moral bashkëkohor». Miliona njerëz të rindërave formojnë kuptimin e jetës ideale në bazë të kinemasë e të romanëve, e kështu më vonë gjinden të turpëruar e të penduar. Artistët dhe artistet imorale që janë të dhënë mbas kësaj jete, bëhen heronjtë e brezit të ri. Gjithashtu edhe shumë salsa vallzimi shpesh herë janë bërë vende ku kryhen lloj lloj imoralitetesh. Heronjtë e dëlirësisë sikurse kanë qenë Jozefi dhe të tjerët (Gjeneza 39), tani huk merren më si shembull. Kështu edhe një Zulu<sup>2</sup> i pagdhëndur i cili nuk do të nguronte të dënonte me vdekje atë që bën imoralitet, do mund t'i mësonte diçka rinisë

<sup>1</sup> Sodoma e Gomorra dy qytete plot me mëkate, që përmenden në Bibel. Dy qytete që kanë pasur imoralitet dhe nuk besonin te Zoti. Mbas kësaj Zoti i shkatërrroi këto me zjarr të dërguar nga qielli.

<sup>2</sup> Zulu: popull primitiv në Afrikën e Jugut.

sonë të civilizuar, e të çohet kundra nesh ditën e gjyqit. Zoti na mëson që të mos luajmë me imoralitetin, por të largohemi prej tij. «Çdo mëkat të cilin bën njeriu është jashtë trupit, por kurvërimi mëkaton kundra trupit. Nuk e dini ju që trupi i juaj është vepra e Zotit që jeton tek ju? E që ai jua ka dhënë dhe nuk e keni pasur?» (1. Kor. 6.18-19).

«Në se dikush e prish veprën e Zotit, atë do ta vrasë Zoti, sepse tempulli i Zotit është i shenjtë dhe ky tempull jeni ju» (1. Kor. 3.17).

### 3. Derrri

Paraqet mëkatin e dehjes dhe të grykësisë. Është një kafshë e ndyrë e cila ha çdo gjë pa marrë parasysh a është e pastër apo e pisët. Gjithashtu edhe një zemër e papastruar kaperdin një propozim të ndyrë, shprehje të ndyra, fotografi të ndyra, literaturë të ndyrë etj. Trupi i kushtuar veprës së Zotit të gjallë, prishet me ushqimin e ndyrë, me mësimet e ndyra, siç janë: pija, pirja e duhanit, përdorimi i opiumit (drogës), gjëra që, kohët e fundit, janë përhapur shumë si kurrë më parë.

Vetëm fuqia e Zotit mund të të çlirojë e të të shpëtojë nga fuqia e djallit. Kështu një shumicë njerëzish janë lëshuar e pijnë duhan brënda ndërtesave **kishtare**, duke e konsideruar këtë si një gjë të zakonshme, dhë me tymin e qelbur ata prishin atë që është vepra e Zotit (trupin e tyre).

«Nuk e dini se jeni vepra e Zotit dhe se shpirti i tij qëndron tek ju?». «Kush e prish veprën e Zotit edhe Zoti do ta shkatërrojë atë» (1. Kor. 3.16-17; 6.18-19).

Njeriu është përherë llupës dhe i pangopur në sytë e Zotit. Ne hamë për të jetuar, dhe jo të rrojmë për tëngrënë. Lakmia nuk mund të mbarojë edhe kur është e ngopur, ajo bërtet gjithmonë: «Ma jep, Ma jep»; «akoma, akoma!».

Sipas ligjit (thuhet në testamentin e vjetër të Biblës) lакmuesi dhe pјанечи duhesin goditur me gurë (Deut. 21.18-21). «Sepse i pangopuri dhe pјанечи varfërohen, dhe të tjerët i veshin me xhingla». «Kush shoqërohet me hasmin.e tij, turpëron babain e vet». Pijet e këqija as që duhet t'i permendim. Pija, éshtë e njojur dhe pëlqehet. Zoti me fjalën e tij na thotë që pјанечi nuk do ta gëzojë mbretërinë e Zotit. Pija nuk éshtë ushqim. Ajo éshtë pijë e vdekur e cila të trullos dhe i bën njerëzit të çmendur. Bëhen të pamoral, bëjnë vrasje, të cilat pa pijen nuk do t'i kishin bërë. «Qesharake éshtë vera vikamë e pijë e fuqishme, nuk éshtë i mençur asnjeri, që prej saj dehet» (Prov. 20.1).

Ata që prodhojnë dhe shesin pijë të ndryshme janë gjithash tu mëkatarë ndaj Zotit, sepse Zoti thotë: «Të mjerë ata të cilët bëhen të fortë duke pirë verë, dhe trima në përzierjet e pijeve» (Isai 5.12).

Mos i besoni: «As lакmuesit, as kryelartit, as kurvarit, as homoseksualëve, as hajdutëve, as pјanecëve, se asnjeri nga këta nuk do ta gëzojë mbretërinë e Zotit» (1. Kor. 6.9-10).

Janë të njoitura mëkatet e natyrës sonë, si p.sh: lакmia, imoraliteti, papastërtia, paturpësia, idhujtaria, kryelartësia, xhelozia, armiqësia, inati, frika, smira, pija, vjedhja. Ata të cilët bëjnë kështu nuk kanë për ta gëzuar mbretërinë e Zotit (Gal. 5.19-21).

«Dhe mos u dehni me verën në të cilën éshtë skëterra, por mbushuni me Shpirtin e Shenjtë» (Efes. 5,18).

Jezusi kështu i thërret të eturit: «Kush éshtë i etur, le të vijë tek unë të pijë!» (Gjoni 7.37-38).

«O të etur sa të jeni, ejani këtu tek unë, e pini ujë, edhe ju që nuk keni para ejani; blini e hani pa para, blini verë e qumësht pa paguar» (Isai 55.1). «Ai që do të pijë ujin që do t'i jap unë nuk do të ketë më etje për tërë jetën, sepse uji që do t'i jap unë, ka për të qenë tek ai burim i pashtershëm i cili nxjerr ujë përgjithmonë» (Gjoni 4.14).

#### 4. Breshka

Flet për dembelin që pret dita-ditës dhe nuk bën asgjë.

Pabesueshmëria si mëkat i pakënaqësisë. «Dembelin e vret dëshira, sepse duart e tij nuk duan të punojnë» (Prov. 21.25-26). E Jezusi u flet bijve të Izraelit: «Mos u bëni dembela, ta zotëroni tokën» (Luka 13.24). «Ai që kërkon do të gjejë». Mbretërinë e qiellit me fuqitë e të fuqishmit e marrin» (Mateu 11,12).

Dembelizmi në lidhje me shpëtimin e të mirave shpirtërore, na çon drejt në humbje. Na ndalon nga lutja, nga dëshira për të kerkuar, thellësinë e mrekullueshme të Zotit dhe na udhëheq drejt shkatërrimit. Kur Zoti të thërrret që ti t'ia japësh zemrën sot, djalli të flet në vesh, që atë ta bësh nesër ose ndonjë ditë tjetër më të përshtatshme, e cila ndoshta nuk do të vijë kurrë-e ti vdes pa Krishtin dhe nuk shpëton. Zoti thotë: «Në qoftë se e dëgjoni sot zërin e Tij, mos e ngurësoni zemrën tuaj» (Ebr. 3.7-8). Sa e sa persona kanë humbur tashmë shpirtin duke e lënë shpëtimin për një ditë tjetër, e cila në të vërtetë kurrë nuk ka ardhur! «Dita e nesërme nuk është jotja».

Magjistarët në Afrikën e Jugut përdorin shpesh guackën e kurritit të breshkës dhe këtu ai përfaqëson mëkatin e shtrigërisë. Ne kemi detyrë që në kohën e fatkeqësisë ose të humbjes, të thërrasim Zotin Qiellor i cili është i gatshëm për të na ndihmuar, dhe jo të mbështetemi në të mirën dhe të këqijat e fatit, «Zoti cakton hapat e secilit njeri» (Psalmi 37,23).

«Sepse ndihma nuk vjen as nga lindja e perëndimi, as nga shkretëtira e nga malet. Jo, Zoti është ai i cili gjykon (Psalmi 75.6-7). Zoti u ka folur bijve të Izraelit: «Të mos gjindet tek ti kush kishte për të parë djalin e tij ose vajzën e vet nëpër zjarr, as fallxhorët, as kush parashikon sipas yjeve, as shortarët. As kush merret me shpirrat e këqinj, as kush pyet të vdekurit (sikur është spiritizmi), sepse kush vepron kështu është i neveritur nga Zoti» (Deut. 18.10-12). Përjashta mbeten të shthururit, magjistarët, ata që merren me kurvëri, vrasësit, adhuruesit e idhujve dhe të gjithë ata që duan ose vënë në

zbatim gjenjeshtrën (Ap. 22-15). «Mos iu drejtoni shpirtërave, as shortarëve, mos i konsultoni që të mos ndoteni prej tyre.

Unë jam i Përjetshmi, Zoti juaj» (Lev. 19.31). «E në qoftë se ju thonë: Pyetni magjistarët të cilët merren me shpirrat, përgjigjuni: A nuk duhet vallë që populli të pyesë Zotin e tij? A duhet të pyesim të vdekurit në vend të të gjallëve? Ligje dhe dëshmi kërkoni. Në se dikush nuk flet, kështu për atë nuk ka agim» (Isai 8.19-20).

Gjatë leximit të kësaj libreze Zoti të flet duke të thirrur që të pendohesh për mëkatet e tua dhe t'ia dorëzosh jetën tënde, por shpirti i breshkës i cili gjendet tek ju, në zemrën tuaj, mundohet me çdo mënyrë të të këshillojë ty që të largohesh nga Zoti dhe mundohet të të mbushë zemrën me frikë. Çfarë do të thonë rrethi im, shoqëria, të afërmit, në se bëhem me të vërtetë i krishterë? Si do t'ia bëj që nuk do të mund të iki më në ballo, në argëtime e të tjera si këto? Në vend që të shikosh pasuritë e paçmuara të Jezu Krishtit, paqen e tij të këndshme, gëzimin e tij të patregueshëm, mrekullitë e tij, jetën e pavdekshme me plot gëzime.

– Ti në vend të kësaj, fillon të shikosh ato gjëra që duhet t'i harrosh, atëhere kur duhet të lejosh Krishtin të hyjë në zemrën tënde. Nga ana tjetër, ty **frika** të vjen prej njerëzve dhe vdekjes në sytë e djallit. Por Krishti ka ardhur të nxjerrë të gjithë ata të cilët prej frikës së **vdekjes** kanë qenë robër gjithë jetën (Ebr. 2.14-15). Ky shpirt i plogëشت të bën që ta shtysh vendimin për Krishtin deri në momentin që zemra jote bëhet si guacka e breshkës.

## 5. Leopardi

Eshtë një shtazë e egër dhe mizore. Urrejtja, dëshira e keqe shumë herë udhëheqin në zemrën e njeriut dhe jo pak herë e dërgon në rrugën e vrasjes a të vetvrasjes. Ti do të mund të përpiqeshe për të sunduar me forcat e tua ndjenjat e këqija dhe mund të krijoje iluzion se ia ke dalë mbanë, kur, befas, ato shpërthejnë përsëri si një bombë. Më mirë është që ta pranosh

se puna qëndron ndryshe dhe t'i lutesh Jezu Krishtit që të të lirojë. «Mos u trishton tani» (Gjen. 45,5). «Mos lejo të mposhtesh nga inati dhe zemërimi, mos u inatos, kur të tjerët bëjnë keq, që të mos i bësh keq vetes» (Psalmi 37,8). «Mërzia është e pashpirt dhe inati është i keq, por kush mund të qëndrojë në smirë?» (Prov. 27,4). Sepse inati flen në gjii të të pamendëve, prandaj largojeni inatin prej zemrës suaj (Prov. 7,9 dhe 11,10), largoni nga vetja çdo inat e hidhërim (Prov. 3,8). Shumë njerëz me karakter të dobët, pijnë për t'u trimëruar për kryerjen e ndonjë të keqe ose hakmarrjeje, por «pija është helmi i tyre si pickimi mizor i nëpërkës» (Deut. 32,33).

Hakmarrja është e ëmbël në zemrën e gabuesit, por, hakmarrësi ynë është Zoti. Jezusi thotë: «Përqafioje të afërmin tënd si vetveten» dhe «përqafoji armiqjtë e tu».

Zoti ka premtuar që mëkatet tona do t'i falë, në qoftë se ne ua falim atyre të cilët na bëjnë keq. Dëshira e keqe për gjakderdhje gjendet në zemrën e njeriut, por në qoftë se doni që gjithmonë të jetoni në lumturi, vendosni në zemër paqen. Jezusi është i gatshëm për të na dhënë këtë zemër, kur ne e duam këtë lumturi.

## 6. Gjarpri

Ka mashtruar Evën në kopshtin e parajsës, dhe ka shkatërruar bashkimin e këndshëm në kundërshtim me Zotin. Satanai, engjell i rënë, u nxit nga smira ndaj Adamit dhe Evës<sup>3</sup> kur i pa si zotërueshit e tokës, dhe që rronin në një harmoni të pashoqe me Zotin duke ia zënë vendin Luciferit.

Për shkak të zilisë Satanai ka kurdisur planin e shkatërrimit të tyre dhe ka arritur të prishë jetën e tyre të bukur në pajtim me Zotin. E njëjta lakmi e djallit në zemrat e njerëzve shkatërron

<sup>3</sup> Adami dhe Eva janë dy njerëzit e parë të tokës të cilët rronin në një harmoni të mrekullueshme me njëri-tjetrin dhe kishin kontakt të vazhdueshëm me Zotin. Por më vonë u mashtruan nga djalli dhe Zoti i dënoi me vdekje (E shkruar në Bibël, Testamenti i vjetër).

gëzimin e zemrave të tjera kur shikojnë që rrojnë të gëzueshëm në paqe «Xhelozia është e pashpirtë si varri» (Këngë e këngëve 8.6).

Ajo si në punë dhe në vende të tjera të jetës të çon drejt urrejteve të papërskruara. Gjithashtu dhe veprimtarët e krishterë, predikonjësit nuk janë të përjashtuar prej sulmimive të tyre. Mirë do të bëjnë në qoftë se gjithmonë do të ruhen dhe në se janë të plotësuar me «dashurinë e paqen e Zotit e cila, del nga zemrat tona e prej Shpirtit të Shenjtë».

## 7. Bretkosa

Këtu paraqet mëkatin e lakmisë dhe të dashurisë ndaj parasë e cila është origjina e të gjitha të këqijave (1. Tim. 6.10). Në Kongo janë parë disa bretkosa të cilat hanin me qindra e qindra buburreca, dhe në fund plasin e ngordhin.

Njeriu ziliqar nuk është i gatshëm të hapë dorën e tij dhe të ndihmojë të varfërët ose të sëmurët. Përkundrazi mundohet me çdo mënyrë, të ndershme apo të pandershme të mbledhë pasurinë, që ia jep kjo jetë, të cilën në fund krimbi do ta hajë. Jezusi ka thënë: «Mos grumbulloni për vete pasuri këtu mbi tokë ku e brejnë krimbi e ndryshku, ku hajdutët shpërthejnë e vjedhin! Por mblidhni pasurinë në qiell ku nuk e shkatërron as krimbi e as ndryshku, ku vjedhësit nuk shpërthejnë ta vjedhin. Në të vërtetë zemra jote do të jetë atje ku është thesari Yt» (Mateu 19-21).

Akari dhe familja e tij gjetën vdekjen sepse ai lakmonte arin dhe argjendin, gurët e çmuar dhe rrobat plot shkëlqim.

Juda Iskarioti, nxënësi i Jezusit, vari veten, sepse dashuria mbas të hollave e bëri që të tradhtojë Zotin dhe Mësuesin e vet. Nuk qëndron e keqja te paraja dhe tek ari, por te dashuria pér para e cila ka bërë fole në zemrën e njeriut. Me mijëra njerëz (burra e gra), të të gjithë klasave dhe racave shkatërrojnë jetën e tyre dhe jetën e familjes me dëshirën e keqe që, me bixhoz e baste, me

vrapimet e kuajve etj..., shpejt të fitojnë pasuri të mëdha. Dëshira për të arritur dhe për t'u bërë i pasur të çon në vjedhje, në plaçkitje, në vrasje si dhe vetvrasje. Ajo të çon atje sa që njeriu mendon për lavdi: dëshira për sundim -për të sunduar tjetrin, dëshira e sundimit financiar e për të shfrytëzuar të varfërit. Jezusi ka thënë: «Kujdes! Ruhuni nga çdo lloj lakmie, sepse jeta e vërtetë e njeriut nuk varet nga paraja, ose pasuria e tij dhe në qoftë se ajo është shumë e madhe». Ndërsa ky është tregimi mbi një njeri të pasur, por të marrë.

«Na ishte një herë një njeri i pasur, toka e të cilit dha prodhim të madh. Ai tha me vete! Ç'të bëj? Nuk di ku t'i ruaj të gjitha të korrat. Ja një mendim i ndritur! Unë do t'i prish hambarët e vjetër dhe do t'i ndërtoj më të mëdhenj. Atëhere mund të mbledh në to tërë grurin tim, dhe rezervat e mia. Atëhere mund t'i them vetes: O njeri me fat, ke mbledhur gjatë shumë vjetëve pasuri të madhe. Tani merre shtruar, ha e pi e kalo mirë!

I marrë – i tha Zoti – këtë natë ti do të vdesësh. E kujt do t'i takojnë ato që ai ka mbledhur? «Kështu i ndodh atij, që për vete grumbullon thesar, e nuk kujdesohet të pasurohet në sy të Zotit» (Luka 12.16-21). «E ç'i duhet njeriut se fiton tërë botën, por e humb jetën e vet?» (Mark. 8.36).

«Mos u shqetësoni për ushqim e për veshje. Jeta është më e vlefshme se sa veshja» (Luka 12.22-23).

«Zemra juaj do të jetë atje ku do të keni thesin tuaj» (Luka 12.34).

## Satanai

Eshtë babai i të gjitha gënjeshtave dhe i atyre që gënjejnë, është ngacmues i mëkateve të ndryshme. Jezusi ka thënë: «Jujeni fëmijë të djallit – ai është babai juaj – dhe ju veproni sipas vullnetit të tij. Që nga fillimi ai ka qënë vrasës dhe s'ka të bëjë me të vërtetën, sepse në të s'është e vërteta. Kur gënjen, kjo i përgjigjet natyrës së tij sepse është gënjeshtar dhe të gjitha gënjeshtat rrjedhin prej tij» (Gjoni 8.44).

Një gënjeshtër e vogël është po ashtu sa një e madhe. Disa gënjeshtra janë të shprehura, disa të shkruara dhe disa të bëra me vepra. Edhe një njeri me dy faqe është përsëri gënjeshtar, sepse mundohet të jetë diçka që në të vërtetë nuk është. Zoti nuk mund të gënjejë – as i krishteri po ashtu (Titit 1.2).

«Në qoftë se themi se jemi bashkë me të, dhe shkojmë në errësirë, gënjejmë e nuk themi të vërtetën» (1. Gjoni 1.6).

«Jashtë qentë, magjistarët, imoralët, vrasësit, adhuruesit e idhujve dhe kushdo që do dhe përdor gënjeshtra! (Ap. 22.15).

«Perëndia urren ata që bëjnë dëshmi të rreme» (Prov. 6.19).

## Ylli

Paraqet ndërgjegjen në zemrën e njeriut. Aty ndërgjegja është e prishur dhe e keqe, sigurisht tani e vdekur, për gabimet e mëkatet e njëmbasnjëshme, ajo është e verbër dhe e sakatuar, kështu që nuk mund të gjykojë sjelljet e veta. Kjo ndërgjegje e keqe është nganjëherë e qetë, e nganjëherë e shqetësuar. Ajo nuk di kur të kërkojë falje. Ankohet atëhere, kur duhet të kërkojë falje dhe kërkon të falur kur duhet të ankohet. Ndoshta është bërë si hekur i skuqur duke humbur çdo ndjeshmëri për shkak të besimit të lënë e dukë i dhënë mbikqyrje shpirtërave të rrejtur me mësimë djallëzore, duke folur genjeshtra (1. Tim. 4.1-2, Er. 10.22).

## Syri i Zotit

Syri i Zotit shikon çdo gjë që ndodh në tokë. Asgjë para syrit të tij nuk mund të fshihet. Ai shikon dhe gjërat më të fshehta dhe qëllimet e zemrës. Pa marrë parasysh se ti do të bësh ndonjë vepër të keqe në natën më të errët, në malin më të lartë, në gropën më të thellë, ose ku të-duash ti Zoti të shikon. (Në këtë fotografi syri i ngjan dhe vetë fotografisë).

## **Gjuhët e vogla të zjarrit**

Rrethi i zemrës paraqet dashurinë e Zotit e cila rrethon zemrën e gabuar. Për derisa Zoti e urren mëkatin, ai njëkohësisht përqafon njeriun dhe nuk dëshiron vdekjen e mëkatarit, por dëshiron që ai të pendohet dhe të rrojë. Jezusi ka ardhur të shpëtojë fajtorët. Gjuhët e vogla flasin gjithashtu për gjakun e Jezu Krishtit «Qingjin e Zotit i cili i ka marrë të gjitha mëkatet e botës».

## **Engjëlli**

Paraqet fjalën e Zotit. Zoti dëshiron të flasë me njeriun që është i shtypur nën zgjedhën e mëkatit, që ai apo ajo të pendohen, dhe të lejojë që drita dhe dashuria e Zotit të vijnë në zemrën e tyre.

## **Pëllumbi**

Eshtë simboli i shpirtit të shenjtë , shpirti i vërtetë i cili gjykon përfajje, drejtësi e gjyq. Shpirti i shenjtë këtu ndodhet jashtë zemrës së njeriut. Ai nuk mund të banojë atje ku sundon mëkatit (faji). A nuk i përshtatet kjo fotografi zemre gjendjes së zemrës sate? Atëhere, kthehu nga Zoti, hapja zemrën tënde, lejo, që drita e tij të shndriti në zemrën tënde. Besoje Jezu Krishtin e do të jesh i liruar. «Zoti është i disponuar, po, Ai ka dhënë besën që do të ndërrojë zemrën tënde, që do të të japë një zemër të re dhe Shpirtin e Shenjtë do ta vendosë në të. Kjo tregohet në fotografinë që vijon më pas.

## **Fotografia e dytë**


Kjo fotografi tregon një zemër të penduar, e cila fillon të kërkojë Zotin. Engjëlli mban shpatën, Fjalën e Zotit «Sepse fjala e Zotit është e gjallë dhe vepron. Ajo është më e mprehtë se një shpatë

me dy presa, e depërtón aq sa ndan fryshtin, hyn gjér në palcë. Kërkon llogari nga dëshirat më të fshehura dhe nga mendimet e njeriut». Fjala lajmëron që të qajnë për mëkatin e vdekjes. Njerëzve u është caktuar që një ditë të vdesin dhe mbas vdekjes vjen gjyqi». Vepra e mëkatarit dhe e jo besimtarit do të jetë në liqenin e zjarrit i cili digjet në zjarr e në squfur. Në dorën tjetër engjëlli mban një kafkë. Kjo na lajmëron të gjithëve, që një ditë kemi për të vdekur. Trupi ynë që aq shumë e duam, e veshim, e ushqejmë, e zbukurojmë, që i kushtojmë kaq kujdes për të kënaqur dëshirat e tij, është trup i cili ka për të vdekur një ditë. Ai do të tretet dhe krimbat do ta hanë, ndërsa frysma dhe shpirti ynë do të ruhen ndër shekuj dhe, një ditë, do të paraqitet para gjyqit të Zotit.

Këtu në këtë fotografi shikojmë se si mëkatari ka filluar t'u japë rëndësi fjalëve të Zotit.

Frysma e Shenjtë fillon të ndriçojë këtë zemër të errësuar nga mëkati. Drita e Zotit hyn brënda tempullit të saj, errësira do të largohet. Mëkati, të cilin e perfaqësojnë këto kafshë, duhet të ikë. Për këtë, lexues i dashur, lejo që Jezusi, drita e botës, të hyjë në zemrën tënde dhe mbas kësaj errësira dhe veprat e saj duhet të lëshojnë zemrën tënde, siç, është e paraqitur dhe në fotografi. Jezusi ka thënë: «Unë jam drita e botës» (Gjoni 8.12).

Kurrë nuk ke për ta larguar errësirën prej zemrës sate, vetëm me zotësinë tënde, ose vetëm me urtësinë tënde. Mënyra më e sigurtë, më e shpejtë, më vepruese madje i vetmi mjet për të zhavaritit errësirën është të lejosh të hyjë drita. Hëna dhe yjet, minden pjesërisht të na ndihmojnë në natën e arrët, por, kur dielli lind, atëherë, ajo errësirë e ajo drita e vogël zhduken. Jezusi është dielli i drejtësisë. Kur hyri Jezusi në tempullin e Jeruzalemit, i dëboi të gjithë tregtarët. Këmbyesve të parave ua përmbysti tavolinat. Dhe përzuri ata që shisnin qe, desh, pëllumba. Dhe u tha: «Në shkrimin e shenjtë thuhet: Tempulli im duhet të jetë vend ku njerëzit të falen. Por ju e shndërruat në shpellë kusarësh!» (Mateu 21,13). Zemra jote është e caktuar për të qenë shtëpia e



2

2. Zemra mëkatare në kërkim të shpëtimit.


Zotit, vepra e Zotit. Ai do të jetojë në të, që t'ju mbushë zemrën me dritë, dashuri e fat. Jezusi nuk ka ardhur vetëm për të falur mëkatet tonë, por ka ardhur dhe për të na nxjerrë dhe të na shpëtojë nga fuqia e pushtetit të mëkatit.  
«Në qoftë, pra, se Biri ju cliron, atëhere me të vërtetë do të jeni të cliruar» (Gjoni 8,36).

## Fotografia e tretë

### Zemra e të penduarit

Kjo fotografi na tregon zemrën e një njeriu mëkatar me të vërtetë të penduar. Ai tani shikon sa të rënda dhe të tmerrshme janë mëkatet që ka bërë, për të cilat Jezusi ka vdekur në kryq. Kur ai shikon kryqin të cilin lajmëtar i Fjalës i tregon, kjo nuk e trishton më, madje ai pendohet shumë për mëkatet e shumta që ka kryer. Në çastin në të cilën ai takon Dashurinë e madhe të shfaqur te Jezu Krishti, kjo Dashuri e madhe depërtón në zemrën e tij dhe ai fillon të kuqtojë që Jezu Krishti, Biri i Zotit, ka ardhur të shlyejë mëkatet e tij, dhe ka qenë i gatshëm që në vend të tij të vdesë në «drurin e mallkuar». Ai mëkatar i penduar shikon tani qartë të vërtetën që Jezusi ka qënë rrahur, kurorëzuar me gjëmba, shpuar në këmbë e në dorë dhe ka vdekur në kryq, për mëkatet tonë. Ajo pamje, tani e forcon zemrën dhe jetën e tij. Dhe kur lexon fjalën e Zotit në të cilën shikohet si në pasqyrë, ai gjithmonë e më shumë vëren se sa shumë i ishte larguar Atij, dhe kishte thyer urdhërimet e tij. E kështu e merr mërzia e thellë fetare e pendimit para Zotit; Jezusi i afrohet. Dashuria dhe mirësia e Zotit hyjnë në zemrën e tij, deri sa ai vetë fillon të shikojë që, «Gjaku i Jezu Krishtit, Birit të Zotit, na pastron ne nga çdo mëkat». Zoti është afër atyre të cilët janë të penduar në zemër, dhe shpirrat e penduar i shpëton (Psalmi 34,18). Dhe përsëri fjala e Zotit na flet.

«Por unë shikoj në atë që është i përvuajtur e në atë që i është kushtuar shpirtit, në atë i cili kujdesohet për fialët e Jezusit: «Djalë ose vajzë mos u frikëso, të falën të gjitha mëkatet e tua».



3

3. Zemra e penduar.

Dhe deri sa shikon vazhdimisht në Kryqin dhe në gjakun e derdhur të Jezusit duke besuar që gjithë ajo është bërë për të, fillon të kuptojë se mëkatet e tij janë të marra prej Atij, sepse Jezusi i ka marrë mundimet e sëmundjet.tona» (Isai 53.56). «Ai ishte i varrosur për gabimet tona, i rrahur për padrejtësitë tona... dhe Zoti lëshoi mbi të padrejtësitë e të gjithë njerëzve (Isai 53.4-6). Shpirti i Shenjtë e dashuria e Zotit marrin në Tokën e tyre zemrën e pastruar. Duke shikuar në kryq dhe te Jezusi, ai fillon të kuptojë që mëkatet e tij janë të falura dhe fiton vërtetësi në zemrën e tij, se gjaku i Jezusit, Birit të Zotit e ka pastruar nga të gjitha mëkatet (1. Gjoni 1.7). Ai tani është i sigurt që ai që beson te Jezu Krishti nuk ka për të vdekur dhe vetëm do ta ketë jetën të pavdekshme (Gjoni 3.16). Sepse nga Jezusi «Kemi shpërbimin me anë të gjakut të Atij e faljen e gabimeve, sipas veprave të pasura që na ka lënë» (Efes. 1.7). Dëshirat e gabueshme të trupit, tani i lëshojnë vendin dëshirës së thellë, të rrojë për Zotin dhe t'i shërbej Atij, «i cili është i pari që na ka puthur». Në vend që të puthë botën dhe gjërat e botës, ai tani puth Zotin dhe gjërat e mrekullueshme të Zotit. Për këtë shkojmë që shtazët të cilat përfaqësojnë mëkatin janë tani jashtë zemrës së tij. Satanai kundër dëshirës së tij lëshon vendin e banimit. Ai mendon se përsëri do ta gjejë hyrjen. Për këtë Zoti na këshillon të bëjmë roje dhe të falemi që ta kundërshtojmë djallin, për ta larguar nga ne.

## Fotografia e katërt


Kjo fotografi na flet për të krishterin i cili ka gjetur qetësinë dhe shpëtimin nëpërmjet flijimit të Zotit dhe shpëtimtarit tonë Jezu Krisht, e për këtë nuk lavdërohet me asgjë tjeter perveç «me kryqin e Zotit tonë Jezu Krishtit me anë të të cilit bota është kryqëzuar për Atë dhe Ai për botën» (Galat. 6.14). Jezusi ka vdekur në kryq, kështu dhe ne «prej mëkateve vdesim e prej drejtësisë së tij jetojmë» (1. Pjetri 2.24). Ne na del si detyrë, të ecim sipas Frymës së Shenjtë, dhe të mos shkojmë pas veseve të kësaj bote (Galat. 5.16,25).

Kollona, në të cilën Jezusi ka qenë lidhur si dhe manteli të cilin ia kanë hequr nga trupi paraqiten në foto, gjithashtu paraqitet në zemër kamzhiku e shkopi, me të cilat e kanë rrahur. Ai u vra për shkak të mëkateve tona sepse, «Tek ai ka qënë paqja jonë».

Herodi dhe njerëzit e tij e kanë përqeshur e mbasi e kanë rrahur i kanë vënë kurorën me ferra në kokë në vend që t'i vendosnin kurorën e artë. I kanë dhënë një shkop në dorën e djathët - në vend që t'i jepnин skeptrin mbretëror. Janë tallur para tij duke thënë: «Tungjatjeta, Mbret i Judeje». Kanë pështyrë mbi të e pastaj kanë marrë shkopin nga dora e tij dhe e kanë rrahur në kokë. Dhe mbasi e kanë munduar në mënyrë të turpshme, e kanë çuar për ta kryqëzuar. Ka shumë të ashtuquajtur të Krishterë, të cilët falen në kisha, këndojnë këngë për Zotin, por prap se prap me veprat e tyre të këqija përsëri e gozhdojnë shpëtimtarin e tyre. «Jo çdo njeri i cili më thotë vazhdimisht: O ZOT, do të hyjë në mbretërinë e Zotit, por vetëm ai që kryen vullnetin e Atit tim» (Mateu 7.21-27).

Në këtë foto, gjejmë dhe qesen me para të Judës i cili e ka tradhëtuar Zotin Jezus dhe e ka dorëzuar për 30 aspra argjendi, sepse dashuria për para ka pushtuar zemrën e tij dhe i ka marrë mendjen. Llampa dhe zinxhirët kanë qenë në duart e ushtarëve që kanë ardhur natën për të marrë Jezusin. Zarët u përdorën nga ushtarët për ndarjen me short të rrobave të Krishtit. E kështu kanë plotësuar profecinë: «Ndajnë në mes tyre teshat e mia dhe mbas tyre hedhin shortin» (Mateu 27.35). Çdo gjë e kanë marrë nga Jezusi por, atë e kanë mohuar duke thënë: «Nuk dëshirojmë që ky njeri të na drejojë».

Njerëzit duan të marrin të gjitha bekimet e Zotit, shiun dhe diellin, por nuk duan t'i nënshtrohen autoritetit të Tij të lartë. Për disa Zoti është i mirë dhe i dashur vetëm në kohën e halleve dhe trishtimit. Ushtarët me shigjetë kanë shpuar kraharorin e Jezusit dhe zemrën e tij, «dhe menjëherë ka dalë gjak dhe ujë» (Gjoni 19.33-27).



4. Kryqi me Krishtin.


Para se të këndojë këndezi Pjetri e ka mohuar tri herë Jezusin, por pastaj duke qarë me lotështë penduar. A e pranon ti Jezusin me fjalë e me vepra? Apo, para njerëzve, mbrohesh me të? Jezusi ka thënë: «Kushdo që më pranon para të tjerëve do ta pranoj dhe unë atë para Atit tim në Qiell. Dhe kush më mohon para njerëzve, atë do ta mohoj edhe unë para Atit Tim në Qiell (Mateu 10.32-33). Jezusi ka thënë dhe këtë: «Kush nuk e merr mbi vete kryqin e tij, (dhe të vijë) mbas meje, nuk është i denjë as i dëshirueshëm përmua (Mateu 10.38). Të lumtur janë ata që rrijnë në shkëmb me Jezu Krishtin!

## Fotografia e pestë

Na paraqet një zemër të pastruar dhe të shënjtëruar të mëkatarit të shpëtuar nga mëshira dhe falja e Zotit. Ajo është bërë me të vërtetë vepër e Zotit, seli e Zotit, Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë. Sipas premtimit të Zotit Jezu Krisht: «Kush më do mua dhe do t'i zbatojë fjalët e mia edhe Ati im do ta **dojë** dhe do të shkojnë tek Ai e do të banojnë me Atë» (Gjoni 14.23).

«Zoti do t'i rrëzojë nga froni sundimtarët, ndërsa të përulurit do t'i lartësojë» (Luka 1.52). Tani zemra është bërë vepra e vërtetë e Zotit. Mëkatë është dëbuar. Në vend të kafshëve të ndryshme që e kishin pushtuar me Satanain, babain e rrenave, tani shikojmë në të Shpirtin e Shenjtë, Shpirtin e së vërtetës, i cili banon në zemër.

Në vend që të bëhet çerdhe e mëkateve, zemra është bërë kopsht i bukur dhe i prodhueshëm me fryte, me frytet e Shpirtit siç janë: dashuria, gëzimi, paqja, durimi, e mira, mëshira, qetësia, besimi e të tjera që Zotit i pëlqejnë. Tani është bërë degë frytdhënëse e njeriut të vërtetë-Zotit tonë Jezu Krishtit. Sekreti i një bollëku të tillë qëndron në atë: ai banon në Jezus dhe Jezusi e fjalët e Tij banojnë tek ai (Gjoni 15.1-10). Me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë është në gjëndje të ecë në shpirtin dhe të sundojë trupin. Nuk rron më në atë që shikon, ndjen apo përjeton, por rron në



5

5. Tempulli i Zotit.

besim se besimi në Jezu Krishtin është fitorja, e cila sundon botën. Rron me premtimin e gjallë dhe të sigurt, me të cilin është i fortë në besimin e ardhjes së Zotit, Jezu Krishtit. Rron në dashurinë e Zotit e cila zgjat ndër shekuj.

«Lum ata që kanë një zemër të pastër, sepse ata do ta shikojnë Zotin» (Mateu 5.8). Mbreti David e ka ditur që – me gjithë pasurinë e tij e fitoret e tij mbi armikun – beteja më e madhe bëhet brenda zemrës së vet - dhe duke e parë thellë dëshirën e Shpirtit të tij është lutar.

«Zemrën e pastër ma krijo o Zot! Shpirtin e drejtë përtërije te unë» (Psalmi 51.10). Asnjeri nuk është në gjendje të pastrojë zemrën e tij, as ta bëj vvetjet zemrën të pastër, përvèç në se i falet me të drejtë Zotit sikur dhe Davidi ka bërë duke iu lutur Zoti t'i formojë një zemër të re. Zoti ka dëshirë të bëjë gjëra të reja në jetën tënde. Rrobat e tua të arnosura dhe të shqyera të të drejtës vehtiakë , me premtimet e zbrazura, nuk do të bëjnë në zemrën tënde vend të përshtatshëm për burimin e Zotit.

Kurse ai është edhe më shumë i dashur që të të ndihmojë sepse Ai ka thënë: «Do t'ju pastroj nga çdo ndyrësirë e juaj dhe nga çdo e metë e juaja. Do t'ju jap zemrën e re dhe Shpirtin e ri do të vendos tek ju. Do të largoj nga trupi juaj zemrën e ngurtë, e do t'ju jap zemrën prej mishi. Do të vendos brenda tek ju Shpirtin Tim, e do të bëj çmos që të shkonit sipas ligjeve të Mia, dhe të zbatoni në praktikë udhërimet e Mia» (Ez. 36,25-27). Kjo është domethënia e testamentit të ri të cilin Zoti e vulosi me gjakun e Birit të vet, Jezu Krishtit.

Shikojmë që engjelli ndodhet prap në foto. engjëjt janë të caktuar në shërbim të atyre që kanë jetë të pavdekshme dhe kanë urdhër të jenë afër atyre, të cilët e kanë frikë Zotin (Psalmet 34.8; 91.11; Daniel 16.22; Mateu 2.13; 18.10; Veprat 5.19; 12.7-10).

Por edhe djalli ndodhet në këtë fotografi, i vendosur afër zemrës, dhe mezi pret rastin që përsëri të hyjë në banesën e tij të mëparshme. Për këtë ne na këshillohet të bëjmë roje dhe të lutemi, sepse kundërshtari ynë djalli «porsi luan që ulërin vjen përqark duke kërkuar cilin të përpjijë» (Pjet. 5,8). Ai shpesh

shndërrohet si engjëll i dritës, duke mashtruar dhe mundohet që të mashtrojë dhe vetë të zgjedhurit «Beni qëndresë kundër djallit dhe ai do të largohet nga ju» (Jak. 4.7).


## Fotografia e gjashtë

Kjo është një foto e mjerë e një renegati.

Njeri sy fillon t'i mbyllët, prandaj ai fillon të flejë në jetën e krishterë, ndërsa syri tjetër pa turp shikon rrith e rrotull e lidh miqësi me botën. Drita brenda në zemrën e tij fillon të errësohet dhe shenjat në zemër të cilat tregojnë gadishmërinë e mundimeve të Krishtit, tani mungojnë dhe nuk rrinë drejt. Eshtë i rrrethuar me provokatorë të cilëve ngadalë e ngadalë fillon t'u dorëzohet në vend që t'u largohet. Në vend që të dëgjojë zërin e Zotit ai fillon të dëgjojë premtimet boshe të provokatorëve që i bëjnë propozime joshëse. Edhe pse është një ndër ata që e respektojnë Kishën dhe e viziton atë, duke e fshehur besimin e tij nën dashurinë fetare (religioze), dashuria e zotit është ftohur tek ai. Në shpirtin e tij ndeshen prirje dhe opinione të ndryshme. Fillon të ndjekë botën lajkatare dhe harron dashurinë e Zotit. Ylli i ndërgjegjes së tij tashmë errësohet. Kryqi nuk bëhet më i dashur në zemrën e tij, por bëhet një barrë e rëndë e papëlqyeshme. Besimi i tij fillon të luhatet, ndërpërt lidhjen me Zotin nëpërmjet lutjeve, bëhet i pakujdeshëm e pasiv ndaj gjendjes së zemrës së tij, e gradualisht, i jep rast provokatorit i cili pret afér zemrës së tij. Shoqëria mondane i pëlqen më shumë se ajo e besimtarëve.

Shpirti i palloit, mburrja e paraqitjes, mundohet të hyjë tek ai. Ky i krishterë ka harruar që vetëm me anë të mëshirës është i shpëtuar, e kështu bëhet kryelart. Pija troket në derë dhe don të gjejë hyrje.

E gjithë kjo fillon në dukje «si pa të keq», për shembull kur ai gjendet me shokë mondanë në një festë ku ai druan se e konsiderojnë si tip original, si të dobët ose “kalama”. Atëhere



6

6. Zemra e tundur dhe e përçarë.

Satanai i flet që ky rast i vetëm nuk do ta ndryshojë jetën e tij shpirtërore. Mendimet dhe dëshirat e trupit po paraqiten. Ndoshta dëshiron të merret gjerësisht, të dëfrehet me shakatë jomorale e njëkohësisht dhe duke u dëfryer, gëzohet me shoqërinë jomorale, shkon nëpër sallat e ballos duke përtypur të këqijat e sjellura nga djalli, i cili thotë që ajo që bën është e mirë, e jo mëkat. Eshtë e saktë kjo, që nuk mund t'i ndalojmë shpendët grabitqarë të së keqes të na fluturojnë sipër kokës, por jemi të fajshëm në se u lejojmë të vijnë tek ne, e të ndërtojnë foletë e tyre në zemrat tonë duke çelur veprat e tyre të këqija. Në se djallit i zgjatim gishtin e vogël, ai sigurisht do të na marrë tërë dorën, duke na tërhequr shpirtin dhe frymën në skëterrë të përjetshme. Për këtë Zoti na nxit solemnisht t'u shmangemë pasioneve dhe të mos e nënvleftësojmë mëkatin në çfarëdo formë që të na paraqitet.

Përkundrazi duhet të shkojmë tek Jezusi, çliruesi. Njeriu të cilin e shohim se si shpon me thikë zemrën, paraqet përqeshësit dhe armiqtë e krishtërimit. Me buzët e tyre vulgare dhe me gjuhën e tyre shpifëse ata, therin dhe plagosin zemrën e të krishterëve, japin goditje, të cilat zemra e ndarë nuk mund t'i durojë. Frika e thashethemeve, të asaj që mund të bëjnë të tjerët, e bën rob të njerëzve. Mërzitja dhe zemërimi shfaqen në periudha krize dhe zhgënjimi dhe futen forcërisht në atë zemër.

Dhe gjarpëri i xhelozisë, i cili lajmërohet atëherë kur të tjerët bëhen më të pasur dhe të suksesshëm, do të hyjë ngadalë dhe pa e parë askush dhe, po i lamë një shteg të vogël, do t'i çelë derën antipatisë dhe mëndjemadhësisë. Dashuria për pasuri shumë lehtë mund të na hyjë në zemrat tonë, në se nuk i mbahemi vërejtjes së Zotit tonë Jezu Krishtit i cili na thotë: «Rrini zgjuar e lutuni që të mos dështonit në provën e zjarrit që po vjen. Jeni me qëllime të mira, por dhe jeni njerëz të dobët» (Mateu 26.41). «Pra kush mendon që po rri drejt, të ketë mendjen që të mos rrëzohet» (1. Kor. 19.12). Vishni gjithë armët e Zotit që të mundeni t'u qëndroni dinakërive të djallit (Efes. 6.11-18).


## Fotografia e shtatë

Kjo foto zbulon gjendjen në të cilën gjendet zemra e një besimtari të rënë, i cili dikur ka qënë i shndritur, dhe i cili kishte kërkuar një herë dhuratën e Qiellit dhe ka qënë i mbushur me Shpirtin e Shenjtë, ndërsa më vonë ka filluar të bjerë poshtë. Kjo fotografi gjithashtu na tregon dhe gjendjen e zemrës së atij njeriu kur nuk ka qënë i penduar, megjithëse i është treguar e vërteta e Ungjillit, «Lajmi i mirë».

Njeriu i cili e shtang zemrën e vet, kur Zoti i del përpara, do të shkojë keq e më keq dhe përpjekjet e tij për t'u ndrecurr do të jenë të kota.

Jezusi e paraqet këtë gjendje zemre me këto fjale: «Kur del një shpir i keq nga një njeri, shkon nëpër vende të shkreta, duke kërkuar një vend ku mund të pushojë. Në qoftë se nuk mund ta gjejë, thotë me vete: Do të kthehem në shtëpinë time nga e cila dola. Prandaj kthehet dhe e gjen shtëpinë të pastruar dhe të rregulluar. Pastaj shkon e merr me vete dhe shtatë shpirtra të tjerë më të këqinj se veten, e hyjnë e banojnë atje. Kështu gjendja e fundit e këtij njeriu bëhet më e keqe se sa e para» (Luka 11.24-26). Dhe me të ngjau, ajo që thuhet: «Qeni u kthyesh në të vjellat e tij dhe dosa e larë është kthyer në llucë të zhgryhet» (2. Pjetri 2.22).

Këto vargje të testamentit të vjetër na paraqesin gjendjen e zemrës së rënë ose zemrës së papenduar. Mëkat me fuqinë e tij të gjenjeshrës, përsëri ka ardhur të zëré vend në këtë zemër dhe për ta sunduar atë. Dhe vetë ftyra deri diku zbulon gjendjen e zemrës. Sepse Shpirti i Shenjtë dhe mëkat nuk mund të rrinë bashkë. Eshtë e pamundur që zemra të jetë njëherësh, dhe vepra e Zotit dhe shpella e Satanait. Engjelli që simbolizon lajmëtarin e Fjalës së Zotit, largohet edhe ai me trishtim, por megjithatë shikon prapa duke besuar që ai apo ajo do të mundohen përsëri të pendohen siç është dhe historia e birit të humbur dhe të penduar (Luka 15.16-18). «Ai kishte kaq shumë uri sa që do të ishte i kënaqur dhe me ushqimin e derrave: por edhe këtë ushqim ia ndalonin. Mbasi erdhi në vete tha: Edhe shërbëtorët e atit tim



7. Zemra e ngurtësuar që është kthyer prapa.

hanë dhe buka u tepron, ndërsa unë po vdes nga uria! Do të shkoj tek im atë e do t'i them: O atë, unë jam fajtor para teje dhe para Zotit; nuk meritoj më të quhem biri yt!... I Ati duke e parë birin e tij të penduar e pranoi dhe e fali».

Por në zemrën e njeriut të kësaj fotoje nuk shikojmë asnjë shenjë pendimi, asnjë lutje Zotit, as edhe një lutje në këmbët e Jezusit për ta falur. Ndërgjegja e tij sikur të jetë e djegur me hekurin e skuqur. Ai i ka veshët, por nuk ndien zërin e Jezusit. I ka sytë, por nuk shikon hummerën e skëterrës që vjen poshtë këmbëve të tij. Atij nuk i vjen më turp që gjithmonë gjendet në mëkatin e vet. Satanai, ka ardhur të sundojë në zemrën e tij dhe ulet si mbret në karrigen e tij. Dhe mbas gjithë këtyre është e mundshme që ai të lavdërohet me rregullin e jashtëm dhe me nderimin e mbajtur fetar, gjë që i ngjan varrit të zbardhur me gëlqere, që nga jashtë duket bukur, por brënda janë eshtra të vdekurish me gjithfarë ndyrësie (Mateu 23.27).

I Ati i gënjeshtrave në këtë rast, merr vendin e Shpirtit të Shenjtë. Çdo kafshë dhe çdo mëkat janë të shoqëruar me demon të posaçëm dhe me një shpir të ndyrë, e tani marrin zemrën e tij. Dhe në se ai vetë dëshiron që të lirohet prej munduesve të këqinj, ata e mbajnë të lidhur. «Kush shkel ligjin e Moisiut, dënohet pa mëshirë me vdekje sipas deponimeve të dy a të tre dëshmitarëve». Mundim akoma më të keq, do të heqë ai që ka shkelur në këmbë Birin e Zotit dhe e ka konsideruar si profan «gjakun e Krishtit» me të cilin u shenjtërua, dhe ka ofenduar Shpirtin e Shenjtë (Ebr. 10.28-29; 2. Pjet. 1.1-14).

Në se i përgjigjet kjo fotografi gjendjes së zemrës sate, lexues i dashur, atëherë lutju Zotit pa e shtyrë, lutju nga brëndësia e zemrës sate. Sepse Ai është «në gjendje të të shpëtojë gjithmonë». Ai do dhe është i kënaqur të t'i fali të gjitha mëkatet, në se ti i shkon me fryshtën e pendimit të sinqertë. Ai mundet të lidhë djallin (Satanain) dhe tërë ushtrinë e tij të territ dhe t'i largojë nga zemra jote, - vetëm në se je i gatshëm që Ai të bëjë këtë. Shko dhe ti, ashtu siç i ka shkuar një lebroz Jezusit dhe i ka


thënë: «Po të duash, mund të më shërosh!» dhe Jezusi pati mëshirë dhe tha: «Dua! Shërohu!» (Mark. 1.10-41). Por në qoftë se vazhdon me ngurimin e zemrës sate dhe më vonë përqafon errësirën dhe jo dritën, aty nuk ka shpresë, nuk ka dritë, sepse vetë zgjodhët vdekjen në vend të Jetës, «sepse pagesa e mëkatit është vdekja» (Rom. 6.23).

## Fotografia e tetë

Këtu shikojmë vdekjen që i afrohet të prapambeturit dhe mëkatarit, të cilët gjithmonë e kanë shtyrë pendimin e tyre për të nesërmen. Ndërsa trupat e tyre janë në gjëndje të rënduar nga shumë sëmundje, shpirti i tyre është plot tmerr për vdekjen që u ka arritur te koka. Embëlsia e mëkateve tani është shuar e tani duhet të shikojë në sy të vërtetën e rrezikshme. Tani mundimet e rënda të ferrit po e shtien në dorë. Edhe në qoftë se tani do të dëshironë të lutej nuk mund të bjerë më në kontakt me Zotin, dashurinë e të cilit e ka lëshuar shumë larg.

Miqtë e tij të mëparshëm frikësohen, të rinjtë afër shtratit të tij dhe fjalët e tyre të zbrazëta nuk e ndihmojnë me. Pasuria e tij e fituar, sigurisht në mënyrë të pandershme nuk mund t'ia zgjasë jetën, as t'i shpëtojë shpirtin, e as t'ia lehtësojë mundimet shpirtërore të vdekjes. Mundohet të bëjë të pamundurën, që të gjejë Zotin, por djalli nuk i jep asnje rast. I duket që të gjitha ato, për të cilat ka jetuar dhe i ka përqafuar, tani e përqeshin dhe asnjeri nuk mund ta ndihmojë, deri sa ka dëbuar dashurinë e Zotit dhe ka rënë nën gjykimin e gjyqit. Sa e tmerrshme do të jetë për atë që do të bjerë në duart e Zotit të gjallë, që vepron! (Hebr. 10.31).

Kishte shpresuar që një ditë do të ishte në rregull me Zotin, ndoshta në shtratin e vdekjes, por tani e shikon që është vonë. Me mijëra e mijëra vdesin papritmas pa pasur kohën që të kërkojnë Zotin. Eshtë e rëndësishme që ta kërkoni Zotin kur mundeni ta gjeni. Në vend që të dëgjojë fjalët shpëtuese të Zotit, mëkatari që po vdes, i cili ka dëbuar hirin dhe dashurinë e Zotit



8. Vdekja e mëkatarit.

gjatë jetës së tij, tani duhet të dëgjojë zërin e Gjykatësit të tij, Shpëtimtarit, të cilin e ka larguar, kur i flet: «Ikni prej meje të mallkuar, në zjarr të përjetshëm, të përgatitur për djallin e për engjëjt e tij!» (Mateu 25.41). «Eshtë vendosur që njerëzit të vdesin vetëm një herë, dhe pas kësaj vjen dita e gjyqit» (Her. 9.27).

## Fotografia e nëntë

Kjo fotografi na paraqet të krishterin, i cili duron dhe fiton kundër të këqijave dhe tundimeve. I tunduar nga të gjitha anët, përsëri qëndron deri në fund, duke dalë më tepër se fitues me ndihmën e Jezu Krishtit. Jo vetëm që u lëshua në garën kristiane, por edhe jeton në të, duke vepruar durueshëm, pa shikuar majtas e djathtas, por vetëm drejt në «Jezus, prijës i përsosur i besimit» (Hebr. 12.1-2).

Satanai e rrethon atë zemër me gjithë ushtrinë e vet dhe mundohet që këtë kriesë të Zotit ta mashtrojë. Mburrja, lakkia ndaj të hollave, demoni i imoralitetit dhe mëkatet e tjera, janë paraqitur gjithashtu në këtë foto. Në vend të leopardit, tani, shikojmë gomarin, sepse shpeshherë mëkatit, në mënyra të ndryshme dhe forma të ndryshme, na afrohet dhe fshihet nën maska dhe emra të ndryshëm.

Por i krishterit zgjuar e zbulon mëkatin edhe atëherë kur vjen me maskë fetare ose si engjëll i dritës, sepse Fjala e Zotit dhe Shpirti i Shenjtë e çojnë te e vërteta.

Në foto shihet një njeri, i cili me gotë të mbushur me verë, kërcen (luan) rreth të krishterit dhe mundohet ta mashtrojë me kënaqësirat e kësaj bote.

Por edhe kjo nuk ndikon në një të krishterë të shenjtëruar, i cili nëpërmjet Krishtit, për mëkatin është me të vërtetë i pajetë.

Përsëri një njeri tjetër, ther me thikë zemrën besnikë. Sharjet e mashtrimet, sulmet që vijnë nga ana e armiqve të Zotit, e shpesh herë dhe nga ata të ashtuquajtur besimtarë, gjithmonë janë thika në zemrën e të krishterëve.

Ai kujton fjalët e Jezusit: «Lum ju kur njerëzit ju shajnë dhe ju përndjekin duke thënë gjithfarë të zezash kundër jush pa të drejtë, sepse më takoni mua.


Gezohuni dhe ngazëllohuni se Zoti do t'ju japë shpërblim të madh»... (Mateu 5.11-12).

Mëkati, trupi, domethënë «yni» ynë, vazhdimesht bëjnë sa mundin për ta shkëputur besimtarin nga Dashuria e Zotit. Por ne mund të themi bashkë me Apostullin me gjësim dhe besim të plotë: «Kush mund të na ndajë nga Dashuria e Jezusit? Mos vallë vuajtja, vështirësitë, persekutimet, uria, lakuqësia, rreziku a shpata.... Jo, në të gjitha këto ne triumfojmë me ndihmën e Atij, që na ka dashur» (Rom. 8.35-37). I përgatitur me të gjitha armët, ai është në gjëndje të mbahet në ditë të keqe dhe të përballojë çdo provë me anë të Jezu Krishtit.

Ylli i ndërgjegjes së tij është i pastër dhe i shkëlqyer. Zemra e tij është plot besim dhe është mbushur me Frymën e Shenjtë. Engjëlli, simbol i Fjalës, i kujton premtimet e çmuara atyre, të cilët fitojnë dhe mbahen deri në fund. «Atij që do të fitojë do t'i jap të drejtën të hajë nga pema e jetës e që është në kopshtin e Zotit». «Kush korr fitoren atë nuk do ta dëmtojë vdekja e dytë». «Atij që do të fitojë do t'i jap të hajë nga mana e fshehur. Do t'i jap gjithashtu, një gur të bardhë dhe mbi këtë gur do të jetë shkruar një emër i ri që askush nuk e njeh, perveç atij që e merr».

«Kush vepron gjer në fund sipas vullnetin tim, atij do t'i jap pushtet mbi kombet, të njejtin pushtet që mora dhe Unë nga Atim».

«Kush korr fitoren do të jetë i veshur me një petk të bardhë të tillë. Nuk do ta fshij emrin e tij nga libri i jetës. Do të dëshmoj botërisht para Atit tim dhe para engjëjve të tij se mua më takon». «Kush korr fitoren, do ta bëj shtyllë në tempullin e Zotit dhe ai do të mbetet gjithmonë atje».



9. Zemra pushtuese.

9

«Kush korr fitoren, atij do t'i jap të drejtën të rrijë me mua në fronin tim, siç e korra unë fitoren dhe tanj jam ulur bashkë me Atin tim në fronin e tij» (Apokal. 2.7,11,17,26; dhe 3.5,12,21).

Thesi i hapur me të holla tregon që jo vetëm zemra e tij, por edhe të hollat e tij i janë kushtuar Zotit. Në vend që të ruajë pasurinë e vet ai ndihmon të varfërit, i jep të gjitha për lavdinë e Zotit.

Buka dhe peshku-paraqesin njeriun që ka jetuar me një jetë të pastër dhe mesatare. Nuk është shkatërruar me pije helmuese ose ushqimin e gjakut dhe nuk e ka prishur me ndonjë ushqim të ndyrë. Nuk i prish kot me kot paratë e veta, as që shkatërron trupin e vet (i cili është vepra e Zotit), me pije, me pirjen e duhanit apo te drogës, por ushqehet gjithmonë me ushqim të mirë dhe të paster. Me rregull dhe nderim ndjek mbledhjet kishtare në çdo kohë e çdo rrethanë. Ai dëshiron të lutet-ngado që të shkojë, në shtëpi të lutjes, o në rrethin e familjes së tij, o në dhomën e veçuar, sepse e di që i krishteri nuk mundet të qëndrojë pa lidhje të përhershme me Zotin.

Libri i hapur është Bibla, të cilën ai e lexon për ditë duke gjetur në tē urti dhe forcë, jetë dhe dritë. Ajo është bërë udhërrëfyese përrugën e tij dhe shpatë për të luftuar armikun. Libri i Shenjtë është buka e përditshme e shpirtit tē tij, uji i jetës që i shuan etjen, uji me tē cilin lahet ~~dhe pasqyra~~ në tē cilën shihet. Ai do tē mbajë kryqin mbi shpatullat e tij, sepse e di që pa kryq nuk ka pushtet. Duke e ditur që është ngritur me Krishtin në lartësirën e jetës, kërkon ato gjëra tē cilat ndodhen lart, gjëra tē përjetshme tē papara ndonjeherë akoma. Eshtë i gatshëm tē takohet me Zotin dhe është si pema që gjendet afër ujit, bën plot fruta. Nuk e njeh frikën e vdekjes, sepse dashurinë e Zotit, tē cilën e ka marrë prej Frymës së Shenjtë e ka mbushur zemrën e tij.

## Fotografia e dhjetë

Jezusi ka thënë: «Unë jam Ai që do t'i ngjallë njerëzit për t'u dhënë jetën e përjetshme. E kushdo që më beson në ketë jetë, nuk do tē vdesë kurrë» (Gjoni 11.25-26).

«Të gjithë ata që e degjojnë fjalën time dhe i besojnë Atij që më dërgoi, do të jetojnë përgjithmonë. Ata nuk do të dënohen.

Tashmë kanë kaluar nga vdekja (shpirtërore) në jetën e përjetshme» (Gjoni 5.24).

«Vdekja e një kristiani nuk paraqet as frikën e as dhimbjen.

Vdekja është asgjësuar! Fitorja është e plotë! O vdekje, ku është fitorja jote? Ku është o vdekje pushteti yt? Le të falenderojmë Zotin që na jep fitoren me anën e Jezu Krishtit, Zotit tonë!»

(1. Kor. 15.54-57).

Ai i cili ka ecur dhe jetuar me Jezusin, nuk i trembet vdekjes. Kur koha e nisjes së tij afrohet, ai me gjëzim do të niset, siç shkruan dhe apostulli Pal: «Kam dëshirë të vdes e të jem me Krishtin, sepse kështu është shumë më mirë» (Filip. 1.23).

I krishteri dëshiron që të shikojë fytyrën e Jezusit, fytyrën e Atij, i cili ka vdekur për të në Kryq. Dhe Shpirti i Shenjtë i kujton fjalët e Jezusit: «Le të mos frikësohet zemra juaj! Besoni te Zoti dhe tek unë. Shumë shtëpi janë në Atin tim... do të vijë persëri dhe to t'ju marrë pranë vetes sime, që të jeni dhe ju atje ku jam unë» (Gjoni 14.1-4).

«... Gjërat që s'i ka parë syri dhe që s'i kanë dëgjuar veshët dhe që nuk kanë arritur në zemrin e njeriut, janë ato që ka përgatitur Zoti për ata që e duan» (1. Kor. 2.9). Nuk ka gjuhë të pershatshme në botë, me të cilën njeriu do të mund të pershkruajë lumturinë e vendeve qiellore, të përgatitura për ata që në tokë ecin me hapat e Zotit tonë Jezu Krishtit. Në vend të skeletit të tmerrshëm (vdekjes) në këtë fotografi të fundit shihet Engjelli ose lajmëtar i Zotit. Ai pret të çojë te Zoti shpirtin e vertetë. Fryma dhe shpirti ndahen nga lidhja e këtij trupi të vdekur dhe fluturojnë nëpërmjet derës së hapur të qillit në krahun e Atij, të cilin shpirti i tij e ka përqafuar, për të cilin ka jetuar dhe ka vdekur në tokë. Në praninë e Zotit e pret mirëseardhja e gëzueshme, ku Zoti dhe Mësuesi i tij përshëndet me këto fjalë pritëse: «Të lumtë, ti je njeri i mirë dhe besnik!... Hyrë në gjëzimet e zotit tënd!» (Mateu 25.21).



10

10. Futu në lavdinë e Zotit tênd.

«E çmueshme është në sytë e Zotit vdekja e të drejtëve të tij» (Psalmi 116.15).

«Kështu – tha Shpirti i Zotit – ata do të pushojnë nga mundimet e tyre dhe do të gëzohen, sepse i percjellin veprat e tyre (që deshmojnë për ta)» (Apokal. 14.13).

### Këshilla e fundit

Lexues i dashur, le të të ndihmojë Zoti që t'i dorëzosh zemrën tënde Atij i cilit të puth, sepse ai të thërret tani duke të folur: «Djali (vajza) im, jepma zemrën tënde» (Prov. 23.26).

Dorëzoja zemrën tënde të lodhur e të penduar, kurse Ai do të të japë ty zemrën e re e në të Shpirtin e ri. Mos lejo të gënjejhesh prej zemrës sate të rrejtur, për të plotësuar dëshirat e saj, sepse: «Kush i beson zemrës së vet, është i paditur, dhe kush shkon në dije të vërtetë do të shpërblehet» (Prov. 28.26). Lëri mëkatet e tua dhe mbaje të drejtën, «sepse pagesa e mëkatit është vdekja; por mëshira e Zotit ështëjeta e përjetshme me anë të Jezu Krishtit» (Rom. 6.23).

Dhe ju të cilët ia keni dorëzuar zemrën Jezu Krishtit «t'u përbaheni fort fjalëve të shendosha, me besë e dashuri, e cila është tek Jezu Krishti (2. Tim. 11.13). Për të njejtin shkak Pali në (2. Tim. 1.12) thotë: «Nuk tërhiqem nga kjo, sepse e di se kujt i besova. Jam i bindur se Ai mund të ruajë të sigurt deri në ditën e gjyqit atë që mua më besoi». Lartësoni veten tuaj mbi besimin tuaj të shenjtë, faluni dhe qendroni në Dashurinë e Zotit, duke shikuar nga Jezusi, i cili është Rruga e Vërtetë dhe Jeta, Ai shpejt ka për të ardhur për të marrë të tijtë, «Mbret mbi mbretërit, Zot mbi zotët».

«Zoti ka fuqi t'ju ruajë nga dështimi dhe t'ju çojë atje ku do të shihni pa të meta dhe plot gëzim madhështinë e tij. Ai, i vetmi Zot, na shpëton ne me anë të Jezusit, Zotit tonë. Atij i qoftë madhështi, madhëri, fuqi dhe pushtet, tani dhe përgjithmonë!» (Juda 24.25). AMEN.

**A SPECIAL WORD FROM ANGP**  
**UN MONDE SPÉCIAL DE L'ANGP**  
**UMA PALAVRA ESPECIAL DA ANGP**

This booklet "The Heart of Man" is available in over 538 languages and dialects spoken throughout the world (Africa, Asia, The Far East, South America, Europe, etc.) Our Heart Book is now also available on cell phones, tablets, etc from [www.anqp-hb.co.za](http://www.anqp-hb.co.za) or as an APP "Heart of Man" on Android phones.

Le livre du "Coeur de l'homme" peut etre obtenu en plus de 538 langues et dialectes parles dans le monde entier, a savoir: Afrique, Amerique, Asie, Extreme Orient, Europe. Notre Livre du Coeur est maintenant aussi disponible sur votre Telephone cellular, plaques, etc. de [www.anqp-hb.co.za](http://www.anqp-hb.co.za) ou comme une Application "Heart of Man" sur telephones Android.

Este livro "O Coracao do Homem" e obtfdo em mais de 538 linguas e dialectos falados em todo o mundo, a saber: (Africa, Asia, America do Sul, Extremo Oriente, Europa, etc). O nosso Livro O Coração do Homem tambem esta agora disponivel em telefone celular, tablets, etc. de [www.anqp-hb.co.za](http://www.anqp-hb.co.za) ou como um aplicativo "Heart of Man" nos telephones celulares Android.



The 10 heart pictures contained in this booklet are also available in the form of large coloured picture charts (86 x 61cm) bound together in a set of 10 pictures. These "Heart Charts" can be obtained with European or African features and are particularly suitable to be used in conjunction with the Heart Book for class-teaching, open air evangelization etc. Kindly contact us to ascertain the latest subsidized price of this chart.

Les 10 images du coeur qui figurent dans ce livre peuvent etre obtenues en tableaux de couleur, format 86 x 61 cm, avec des physionomies europeennes ou africaines. Ils peuvent etre utilises en meme temps que le livre du coeur pour des classes bibliques, a

**l'ecole du dimanche ou lors de reunions de plein air. Soyez aimable de nous contacter pour assurer les derniers prix en cours du tableau.**

**As 10 imagens do coracao, contidas neste livro podem ser obtidas num conjunto de 10 imagens em colorido no tamanho de (86 x 61 cm). Estes "Cartazes do Coracao podem ser obtidos com caracteristicas Europeias e Africanas e podem ser usados em conjuncao com o mesmo livro em classes de ensino biblico, evangelizacao ou ao ar livre. Agradeciamos que nos contacta- se para confirmacao do ultimo preco dos cartazes.**



**Kindly write to us if you are able to assist us with further translations of our free Gospel literature, informing us of the language into which you could translate this Gospel literature. Your assistance would be appreciated.**

**If you have found salvation in Christ, or have been otherwise blessed through our Gospel literature, please let us know. We would like to thank God with you, and remember you further in our prayers.**

**Nous vous invitons a nous contacter pour faire des arrangements concernant de nouvelles traductions de notre litterature, nous informant de la langue dans laquelle vous pouvez traduire cette litterature evangelique. Votre aide sera beaucoup appreciee.**

**Si vous avez trouve le salut en Christ ou si vous avez ete beni par notre litterature, nous vous prions de nous le faire savoir. Nous aimerions remercier Dieu avec vous et prier pour vous.**

**Nos vos convidamos a nos contactar, afim de fazer qualquer arranjo concernente a novas traducoes de nossa literatura em outras linguas. Vossa assistencia sera muito apreciavel.**

**Se tem encontrado a salvacao em Cristo, ou se tem sido abençoado por intermedio da nossa literatura evangelica, faça o favor de nos**

informar. Pois nos gostarfamos de agradecer a Deus juntamente convosco, e lembra-lo sempre em nossas oracoes.



For free Gospel literature, books and tracts in over 538 languages, write to:

Pour obtenir gratuitement de la litterature evangelique, des livres et des traites en plus de 538 langues, ecrivez a:

Para obter gratuitamente a literatura evangelica, livros e folhetos em mais de 538 linguas diferentes escreva para:

E-MAIL: [info@angp-hb.co.za](mailto:info@angp-hb.co.za)  
[info@angp.co.za](mailto:info@angp.co.za)

**ALL NATIONS GOSPEL PUBLISHERS**  
**P.O. Box 2191**  
**PRETORIA**  
**0001**  
**R.S.A.**

**A Gospel Literature Mission financed by donations**

**Une Mission de litterature evangelique financee de dons**  
**Missao de literatura Evangelica financiada por donativos**

(Reg. No. 1961/001798/08)